

VENDIM
Nr.75, datë 2.12.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 20 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të pikës 1.4 të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.46, datë 14.10.2004 “Licenca për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2005, pasi shqyrtoi për fillim procedure kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., për kalimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për hidrocentralet Leskovik nr.1 dhe Leskovik nr.2, te shoqëria “Maksi Elektrik”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit, për kalimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, për hidrocentralet Leskovik nr.1 dhe Leskovik nr.2, nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., te shoqëria “Maksi Elektrik”sh.p.k.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema